

KONTRATË SHITJE KUOTASH

E lidhur në Tiranë, sot më 25 / 05 / 2021, ndermjet paleve si me poshte vijon:

Z. Albert Arapi, shtetas shqiptar, lindur me 10.06.1958 ne Zais ,Mirdite dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit, Karte Identiteti, me Nr. personal F80610293T, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i njohur si SHITESI,



dhe

Z. Gezim Prenga shtetas shqiptar, lindur me 04.05.1975, lindur ne Rreshen, dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit, Karte Identiteti Nr. Personal H50504030W, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i njohur si BLERESI,

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% te Kapitalit te Shoqërisë “EUES Energy” Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L39406001N, me seli ne adresen: , Rruga At Gjergj Fishta Rreshen, (me poshte referuar “*Shoqeria*”);
- B. Shiteshi deshiron t’i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitesi 100 % te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne Shoqerine e siperpermendur.
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Ortakut te vetem te shoqerise, per shitjen e kuotave te shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:



1. Me nënshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "EUES Energy" Sh.p.k
2. Transferimi i pronësisë mbi kuotat dhe regjistrimi i transferimit behet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pavarësisht mënyrës se pagimit te çmimit te shitjes te përcaktuar këtu.
3. Çmimi i shitjes se kuotave, ne vlerën e përgjithshme të rënë dakord prej 150.000 Leke. Çdo pagese qe perben pjese te çmimit te shitjes sipas kesaj kontrate ne favor te shitesit, do te behet ne llogarine bankare te shitesit.
Palet deklarojne e garantojne reciprokisht njera-tjetren se çmimi i shitjes se kuotave eshte i drejte, i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.
4. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjeset e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
5. Blerësi pranon pronësinë e kuotave, 100% te kapitalit te Shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar. Me nënshkrimin e kesaj kontrate Bleresi behet zotërues i 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.
6. Ne rast se Bleresi, brenda nje periudhe nje vjeçare nga data e nënshkrimit te kesaj kontrate, deshton ne shlyerjen e plote te pageses se vleres se plote te kuotave, atehere Shitesit i lind e drejta rimarrjes se 100% te kuotave te Shoqerise.
7. Bleresi mer persiper pagesen e detyrimeve tatimore qe lindin nga realizimi i ketij transaksioni lidhur me Tatimin ne Burim, per fitimin e realizuar nga shitja e kuotave.
8. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) origjinale ne gjuhen Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, Date 14.04.2008. Marrëveshja pasi u lexua prej palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

PALET

SHITESI

Albert Arapi
Perfaqesuar me prokure te posacme nga

Estela Misro (Arapi)



BLERESI

Gezim Prenga